



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:018427
Datë: 14.02.2024
Numri i dokumentit: 05329689

KE.nr. 902/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit “Inel” Sh.P.K., me nr. të biznesit 70613387 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate T.Zh. me zyre në Prishtinë, kundër të paditurit N.P.N.P “Nojtra Construction” me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.D. me zyre në Prishtinë, me objekt kontesti dorëzim i hapësirave afariste në emër të bashkë investimit apo në alternativë kompensim dëmi, jashtë seancës me datën 14.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së ushtruar nga paditësi Inel” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.P.N.P “Nojtra Construction” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti dorëzim i hapësirave afariste në emër të bashkë investimit apo në alternativë kompensim dëmi, lënda e identifikuar me shenjën KE.nr. 902/23 (lidhja: I.EK.nr. 9/2017).
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Komeriale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi “Inel” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 04.01.2017, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, kundër të paditurës

“N.P.N.P “Nojtra Construction” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti njohje dhe dorëzim në posedim të hapësirave afariste në emër të bashkë investimit.

Me parashtresën e datës 25.10.2021, paditësi, duke vepruar sipas aktvendimit të dhënë nga gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.10.2021, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën “N.P.N.P “Nojtra Construction” që paditësit, në emër të participimit në investim në ndërtimin e objektit banesor-afarist i cili gjendet në Prishtinë, Lagjja “Arbëria 3” nën ngastrën kadastrale me nr. 7167 ZK Prishtinë, Blloku C 1C dhe C1 D, të evidentuar në fletën poseduese UL-71914059-10456, t’ia njoh të drejtën e pronësisë dhe t’ia dorëzoj në posedim ngastrat kadastrale të specifikuara si në këtë parashtresë, apo në alternativë t’ia kompensoj shumën prej 79,534.00 EUR në emër të investimit në llogarinë bankare të paditësit, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Ky precizim i kërkesëpadisë është lejuar nga gjykata përmes aktvendimit të dhënë në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor të datës 26.11.2021.

Lidhur me lëndën në fjalë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka vendosur përmes aktgjykimit I.Ek.nr. 9/2017 të datës 17.12.2021, ndërsa Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 862/22 të datës 11.07.2023 ka aprovuar ankesën e të paditurit dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Në rivendosje, lënda është regjistruar në Departamentin për Çështje Ekonomike të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale dhe ka marrë shenjën KE.nr. 902/2023.

Gjykata, në rivendosje, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, morri për bazë shkresat e lëndës dhe vlerësoi kompetencën lëndore në këtë çështje juridike dhe gjeti se Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj Gjykate nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje kontestimore për shkaqet si në vijim:

Gjykata vë në pah se me nenin 13. par.1, nën par. 1.7. të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë ndër tjerash edhe për “kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë

Tregtare”, ndërsa, me par. 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti i Përgjithshëm”.*

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, e meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me një kontest i cili zhvillohet në mes dy shoqërive tregtare dhe i cili për objekt kontesti ka njohjen e të drejtës së pronësisë në hapësirat banesore dhe afariste si dhe dorëzim i tyre në posedim, apo në alternativë kompensim i dëmit në emër të investimit, gjykata vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe jo Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate, pasi që kontesti në fjalë ndërlidhet me të drejtat sendore të palëve ndërgjyqëse, të cilat bazën e kanë në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 902/23, datë 14.02.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.